

MA. Armend MEHMETI

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE NË EVROPË NË SHEKULLIN SHTATËMBËDHJETË

Gjendja politike në Evropë në fillim të shekullit shtatëmbëdhjetë

Shekulli shtatëmbëdhjetë fillon me shqyrtimin e përçarjeve religjioze të cilat rezultuan në gjakderdhje dhe përhapje të konflikteve, në veçanti Lufta Tridhjetë Vjeçare 1618-1648. Gjatë këtij shekulli Spanja e cila ishte fuqi e shekullit të kaluar tani kishte marr tatëpjetën gjersa Franca u ngrit për t'u bërë fuqi evropiane. Anglia ishte kryesisht nën trysinë e problemeve të brendshme politike, përkatësisht me konfliktin ndërmjet mbretit dhe parlamentit, që eskaloi me luftë qytetare. Përkundër problemeve të brendshme Anglia vazhdoi me ndërtimin e flotës ushtarake dhe filloi rrugën drejt shtrirjes së perandorisë përtej oqeanit.

Në anën tjetër Holanda krijoi një flotë të madhe tregtare dhe luftarake përmes së cilës ajo kryente rolin ndërmjetësues në tregtinë botërore, kështu që edhe mallrat nga kolonitë angleze transportoheshin nga anijet holandeze. Me fjalë tjera gjatë këtij shekulli Holanda u bë vendi më i madh kolonial në botë, kolonitë e së cilës gjendeshin në Amerikë, Azi dhe Afrikë.¹

Prusia dhe Austria të cilat lindën nga shkatërrimi i Perandorisë së Shenjtë Romake, filluan të forcohen në saje të eksportit të drithit në

¹ Skender Rizaj, *Histori e Përgjithshme, Koha e Re (1453-1789)*, Prishtinë 1985, f. 315.

Evropën Perëndimore, me ç'rast u forcua aristokracia e vendit. Mirëpo, këto dy shtete filluan të luftojnë mes vete për të dominuar në Gjermaninë shumëshe.²

Nga fundi i shekullit gjashtëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit shtatëmbëdhjetë, Perandoria Osmane ishte ngatërruar në një varg luftërash me shtetet fqinje: Iranin, Austrinë, Poloninë, Venedikun dhe Rusinë, kurse në planin e brendshëm shpesh shpërthenin trazira nga qytetarët dhe klasa ushtarake.

Atë çka historianët e përshkruajnë si sistem i ekuilibrit të forcës, lindi në shekullin shtatëmbëdhjetë nga dështimi përfundimtar i aspiratave mesjetare për universalizëm – një koncept i rendit botëror, që përfaqësonte një përzjerje të traditave të Perandorisë Romake dhe Kishës Katolike.³

Në aspektin social, ra ndikimi i princërve dhe priftërinjve. Në mënyrë stabile u rrit numri, mundësia dhe rëndësia e tregtarëve dhe magnatëve ekonomik, popujve të pasur, gjithë atyre që u njoftuan me pasurinë e re që po sillte revolucionin ekonomik, kurse avokatët, mjekët, profesorët, tregtarët, borgjezët dhe klasa e mesme gradualisht filluan të ndiejnë pakënaqësi me institucionet kufizuese të kohës së tyre.⁴

Zhvillimet politike në gjysmën e parë të shekullit shtatëmbëdhjetë

Pjesa e parë e shekullit shtatëmbëdhjetë shquhet për luftëra fetare ndërmjet katolikëve dhe protestantëve, e cila rezultoi me Luftën Tridhjetë Vjeçare (1618 – 1648). Pos që ishte konflikt fetar, kjo luftë ishte edhe një betejë për interesa ekonomike ekspansioniste të fuqive evropiane. Në këtë luftë fuqitë evropiane hynë me arsyen e mbrojtjes së interesave fetare të besimtarëve të tyre, mënyrë e cila u jepte përkrashje nga populli. Për më tepër, përmes këtyre luftërave monarkët evropianë tentuan të përforcojnë dinastitë e tyre sunduese.

Në fillim të shekullit shtatëmbëdhjetë, situata fetare në Gjermani gjithnjë e më shumë po tensionohej. Po rriteshin incidentet ndërmjet katolikëve dhe protestantëve, posaçërisht kalvinistëve. Më 1608

2 Ibid.

3 Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë 1999, f. 56.

4 Charlton J.H. Hayes, *A Political and Social History of Modern Europe*, Volume I, 1500-1850, New York, 1916 (www.gutenberg.org) .

elementet kalviniste formuan Unionin Protestant, e cila, nxiti krijimin e Lidhjes Katolike më 1609. Në këtë mënyrë, një dekadë para fillimit të luftës, Gjermania ishte e ndarë në taborë rival. Qysh prej fillimit, Lidhja Katolike dhe Unioni Protestant kishin ambiciet e tyre politike dhe fetare. Lufta shpërtheu në Bohemi, me një minoritet të fortë protestant të njohur si Utrakiozët.⁵

Në këtë konflikt u përfshinë edhe fuqitë tjera evropiane qoftë përmes diplomacisë qoftë përmes veprimeve ushtarake. Rol me rëndësi në këtë konflikt luajti Franca. Pasi që ishte vendosur absolutizmi mbretëror, në krye me kardinalin Rishelje, Franca po kërkonte të përforconte pozitat e saja në Evropë. Rishelje, emri i vërtetë i të cilit ishte Arman Zhan de Plesi, ishte një ndër burrështetasit më të shkathtë politik të kohës. Ideali i tij ishte shteti i fuqishëm dhe i centralizuar ku mbreti gëzonte pushtet të pakufizuar. Për t'i realizuar synimet politike ai vuri interesat shtetërore para atyre fetare, edhe pse vetë ishte personalitet fetar.⁶ Me fjalë tjera, politikat e Risheljesë ishin mjaft të thjeshta: për ta bërë fuqinë mbretërore supreme në Francë dhe për ta bërë Francën mbi-zotëruese në Evropë. E para kishte të bënte me heqjen e ndalesave për autoritetet mbretërore dhe triumfin a absolutizmit; e dyta nënkuptonte një politikë të jashtme mjaft energjike, duke rezultuar me shkatërrimin e kundërshtarëve habsburgas. Në të dyja politikat, Risheljeu zbatonte traditat e përgjithshme të shekullit paraprak, posaçërisht ato të Henrit IV, por me shtrirje të gjerë dhe me sukses të pakrahasueshëm.⁷

Gjatë viteve 1625-1629 Danimarka në krye me mbretin energjik Kristain IV (1588-1648) vihet në përkrahje të forcave protestante, në të vërtetë tani Danimarka e merr përsipër udhëheqjen e forcave protestante. Një monark ambicioz, Kristiani kishte zgjeruar pushtetin mbretëror duke marr përparësinë e plotë të autoritetit në rritje që ia kishte dhënë Luteranizmi. Kur ai ndërhyri në luftë, ai kërkoi jo vetëm mbrojtjen e bashkë-fetarëve të tij, por edhe zgjerimin ekonomik e politik të hegje-

5 Crane Briton, John B. Christopher, Rober Lee Wolf, *Modern Civilization, Engelwood Cliffs*, New Jersey, f. 112.

6 *Burime të zgjedhura për historinë e mesjetës*, Universiteti i Tiranës "Enver Hoxha", Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë 1988, f. 282.

7 C. Briton, J. B. Christopher, R. Lee Wolf, *Modern Civilization, Engelwood Cliffs*, New Jersey, f. 112.

monizmit danez mbi Gjermaninë Veriore.⁸

Kur Risheljeu u ngri në pushtet, shumica e shteteve evropiane tanimë ishin përfshirë në këtë luftë. Perandoria e Shenjtë Romake, e cila udhëhiqej nga dinastia Habsburge dhe kishte pushtetin në Austri dhe Spanjë, kishte thyer kundërshtarët e saj protestantë në Gjermani. I alarmuar nga mundësia e ndikimit të Perandorit Ferdinand II, kardinali Rishelje nxiti Suedinë për të ndërhyrë në përkrahje të forcave protestante. Në këtë periudhë Franca ende nuk ishte përfshirë zyrtarisht në luftë, por në mënyrë sekrete ndihmonte aleatët e saj. Pas vdekjes së mbretit suedez Gustavit, lufta mori karakter gjithnjë e më politik. Protestantët gjermanë tani e fituan përkrahjen e hapur të një aleati mjaft të çuditshëm për ta, kardinalin Rishelje, ministër autoritativ i mbretit francez. Edhe pse kardinal katolik, ai hyri në luftë në krah të forcave protestante me qëllim të përlules së Habsburgëve austriak, dhe për të zgjeruar kufijtë francezë mëtanë Rinit, në dëm të Perandorisë së Shenjtë Romake. Pasi Habsurgasit spanjollë ndihmonin të afërmit e tyre, Risheljeu luftoi edhe kundër vetë Spanjës. Në këtë mënyrë lufta u kaloi në një konflikt të madh ndërkombëtar ku religjioni luante një rol të vogël.⁹

Gjatë vitit 1642 Suedia korr suksese ushtarake në tokat gjermane duke rrezikuar thelbin e Habsburgëve. Këto suksese tani filluan më tepër të vështrohen si suksese suedeze sesa si protestante. Kjo nxiti reagimin e mbretit danez Kristainit IV i cili deri më atëherë ishte udhëheqës aktual i protestanizmit, një reagim jo edhe i pazakonshëm në historinë e balancës së fuqisë politike. Tani më i frikuar nga fqinjët suedezë sesa nga austriakët e largët, Kristiani hyri në luftë me Suedinë, duke e parë se tokat e tij ishin invaduar me shumë sukses.¹⁰

Në vitet e saj të fundit, Lufta Tridhjetë Vjeçare ishte shndërruar në një luftë të përgjithshme. Në shtatë dete Spanja dhe Franca sfidonin njëra tjetrën. Në Itali, francezët kishin tentuar ta ndërpresin komunikimin në mes të Austrisë dhe Spanjës habsburge duke kontrolluar vendkalimet e Alpeve. Franca kishte hartuar edhe planin final ushtarak kundër rivalëve habsurgas. Paraprakisht ai lidhi aleanca defensive dhe ofensive me Holandën, Suedinë, me dukën e Rinit, me Zvicrën dhe me

8 Op.Cit, f. 113.

9 Huton Webster, *Early European History*, Nebraska 1917 (www.gutenberg.com).

10 C. Briton, J. B. Christopher, R. Lee Wolf, *Modern Civilization*, Engelwood Cliffs, New Jersey, f. 114.

dukën e Savojit dhe atij të Parmas.¹¹

Habsburgët u mposhtën, kurse Franca dhe Suedia dolën fituese. Kjo luftë e përgjithshme megjithatë kishte një dallim prej luftërave tjera: balanca e fuqisë kishte për t'u arritur pa pjesëmarrjen e një prej faktorëve të saj, Anglisë. Anglia ishte mbajtur jashtë kësaj lufte për arsye të qarta, sepse në gjitha këto vite të luftës Anglia ishte ballafaquar me kriza të brendshme dhe luftëra civile. Neutraliteti i Anglisë ishte siguruar nga rezoluta e mbretit Charles I mbi shpërndarjen e parlamentit, pa të cilin mekanizëm ai nuk do të mund t'i siguronte mjetet për luftë. Në anën tjetër edhe Richelieu kishte hartuar strategji në rast të përfshirjes angleze, të cilën do ta përdorte padyshim sikur të ishte e nevojshme. Agjentët dhe paraja franceze nuk kishin rol të vogël në nxitjen e rebelizmit skocez e cila shkaktoi shpërthimin e parë fatal ndaj despotizmit stuardez. Kur shpenzimet dhe dështimet e luftës e detyruan Çarlsin ta thërrasë parlamentin, Richelieu nuk hezitoi të vendoste kontakte me partinë opozitare, e cila kishte më pak arsye ta përkrahte Spanjën.¹²

Traktati i Uestfalisë

Lufta zgjati gjer më 1648 kur u lidh paqja në qytetet e Uestfalisë, Munster dhe Osnabryk. Në Munster biseduan përfaqësuesit e Francës dhe Perandorisë Gjermane të Habsburgëve, ndërsa në Osnabryk biseduan përfaqësuesit e Suedisë dhe habsburgasve.¹³

Nenet politike të paqes së Uestfalisë siguruan: 1. Secili shtet gjerman ishte i lirë të lidhte paqe apo të bënte luftë pa konsultimin e perandorit – secili princ u pajis me autoritet sovran; 2. Franca mori Alsin, në përjashtim të qytetit Strasburg, iu konfirmua posedimi i peshkopatave të Mecit, Tulit dhe Verdunit; 3. Suedia mori territorin e Pomeranisë duke kontrolluar grykën e Odrit, peshkopatën laike të Bremenit, duke rrethuar qytetin me këtë emër, dhe duke dominuar në grykën e Elbës dhe Vesperit; 4. Franca dhe Suedia arritën të sigurojnë vende në parlamentin e Perandorisë së Shenjtë Romake, duke përfshirë

11 William Robson, *The Life of Cardinal Richelieu*, George Routledge and Co, London 1854, f. 332.

12 Richard Lodge, *Richelieu*, Macmillan and Co, Limited St. Martin's Street, London 1908.

13 S. Rizaj, *Histori e Përgjithshme...*, f. 235.

edhe të drejtat e mbikëqyrjes së çështjeve gjermane; 5. Brandenburgun siguroi Pomeraninë Lindore dhe disa peshkopata përfshirë Magdenburgun; 6. Pushteti perandorak u nda në mes të Maksimilianit të Bavarisë dhe të birit të Frederikut të rrëzuar, secili duke bartur titullin e zgjedhësit; 7. Zvicra, Holanda dhe Spanja u njohën si shtete të pavarura.¹⁴

Sistemi modern ndërkombëtar zakonisht vështrohet si i themeluar me Traktatin e Uestfalisë së vitit 1648, i cili vendosi parimet e shteteve të pavarura dhe sovrane, të cilat parime vazhdojnë të ndikojnë edhe sot në sistemin ndërkombëtar. Sidoqoftë, këto rregulla të marrëdhënieve shtetërore, nuk u trupëzuan për herë të parë në Uestfalia. Ato u formësuan në Evropën e shekullit XVI. Thelbi i këtij sistemi ishte aftësia e një shteti apo koalicioni për ta baraspeshuar fuqinë e një shteti tjetër në mënyrë të tillë që të ishte i pamundur pushtimi i shteteve më të vogla për të krijuar perandori më të mëdha.¹⁵

Traktati i Uestfalisë i vitit 1648 vendosi rregullat themelore që kanë luajtur rolin kryesor në sistemin ndërkombëtar qysh prej asaj kohe, te cilat janë sovraniteti dhe tërësia territoriale e shteteve si anëtare të barabartë e të pavarur të një sistemi ndërkombëtar. Qysh prej asaj kohe, shteteve të mundura në lufte mund t'u merreshin disa territore, por përgjithësisht, atyre u lejohej te vazhdonin të ekzistonin si shtete të pavarura, ne vend që t'i nënshtroheshin fituesit.¹⁶

Zhvillimet politike në gjysmën e dytë të shekullit shtatëmbëdhjetë

Pas traktatit të Uestfalisë betejat dhe politikat e jashtme të shteteve evropiane nga të përqendruarit në çështje fetare kaloi apo u përqendrua në çështjet tregtare dhe përfitimet territoriale. Fuqitë në dobësim e sipër, si Spanja, Polonia dhe Suedia, së paku tentuan ta mbajnë një pavarësi regjionale nga fuqitë në ngritje, sikurse Franca, Prusia dhe Rusia. Beteja për ta mbajtur balancën e fuqisë në linjë dinastie dështoi apo u zhvendos, sidomos në Spanjë dhe Poloni, që gjithashtu shkaktoi tensione. Shkalla e luftës dhe diplomacisë u rritën.

14 C. J. H. Hayes, *A Political and Social History of Modern Europe*, Volume 1, 1500-1850, New York 1916 (www.gutenberg.org).

15 Joshua S. Goldstain, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Dituria, 2003, f. 40.

16 Ibid.

Në mesin e shekullit shtatëmbëdhjetë, ishte e qartë se as Spanja e as Austria Habsburge nuk ishin në gjendje të thyenin sistemin shtetëror evropian, dhe vendosën një formë të re të përtëritjes së institucionit të vjetër, Perandoria Romake. Agresori i vërtetë në luftërat e mëdha të fund shekullit shtatëmbëdhjetë dhe fillim shekullit tetëmbëdhjetë ishte Franca, e cila ishte fituese reale e Luftës Tridhjetë Vjeçare. E shëruar mirë nga plagët e luftërave të saja fetare, duke përjetuar progres ekonomik dhe politik, me një mbret të ri dhe ambicioz në fron, Luigji XIV (1643-1715), Franca ishte e gatshme për ekspansion.¹⁷

Luigji XIV zhvilloi luftëra pushtuese, të cilat zgjatën gati gjysmë shekulli. Luftoi kundër shteteve fqinje: Spanjës, Austrisë, Suedisë, Anglisë dhe Holandës. Luftërat e tij ishin katër: I. Lufta Revolucionare (1667-1668), ku Franca luftoi kundër shteteve fqinje dhe pushtoi disa krahina; II. Lufta holandeze (1672-1678), III. Lufta e aleancës augsburge (1667-1697), aleancë kjo e lidhur në mes Anglisë dhe Holandës, kur ajo e detyroi Luigjin IV të heqë dorë nga disa territore të pushtuara; IV. Lufta për trashëgiminë spanjolle (1701-1714), me çrast fuqitë evropiane rishtazi u bashkuan kundër Luigjit XIV, të cilin e dobësuan shumë.¹⁸

Më 1672 Luigji filloi luftën e tij kundër Holandës, kundër së cilës përfundimisht siguroi një numër të favorshëm të aleatëve, në veçanti Anglinë më 1670, Suedinë dhe disa shtete gjermane. Megjithatë, holandezët rezistuan vendosmërisht nën udhëheqësin e tyre energjik William III Orange, një pasardhës i Williamit të heshtur. Edhe pa Williamin, me siguri Evropa do t'iu kishte përgjigjur dominimit francez përmes ndonjë aleance kundër franceze. Spanja, Perandoria e Shenjtë Romake, dhe shteti ende i parëndësishëm gjerman Brandesburgu-Prusia, u bashkuan kundër Francës dhe aleatëve të saj. Koalicioni anti francez nuk ishte shumë efektiv, gjersa diplomacia franceze shkëputi aleatët përmes Traktatit të Nijmegenit më 1678-1679. Holanda ishte lënë e pacenuar në çmim të neutralitetit të premtuar; Spanja ia dorëzoi Francës qarkun e Burgundisë dhe disa qytete në Holandën spanjolle; Prusia e cila kishte korrur një fitore vendimtare kundër Suedisë në Fehrbellin më 1675,

17 C. Briton, J. B. Christopher, R. Lee Wolf, *Modern Civilization, Engelwood Cliffs, New Jersey*, f. 168.

18 S. Rizaj, *Histori e Përgjithshme...*, f. 288

ishte obliguar nga presioni francez t'ia kthejë Suedisë tokat baltike gjermane.¹⁹

Dështimet e Luigjit XIV

I pakënaqur me prestigjin që kishte fituar në dy luftërat e para, Luigji u ngatërrua me pjesën më të madhe të botës perëndimore, në atë çfarë shihej në atë botë, si përpjekje për të shkatërruar pavarësinë e Holandës dhe pjesës më të madhe të Gjermanisë Perëndimore, dhe për ta vënë gadishullin e madh Iberik nën sunduesin francez. I alarmuar nga përparimi i shpejte i fuqisë franceze, perandori Leopold më 1686 ia arriti formimin e Lidhjes së Augsburgut me Spanjën, Suedinë, dhe disa princër gjermanë, më qëllim të ruajtjes së integritetit territorial të Perandorisë së Shenjtë Romake. Në Amerikë, ku paralelisht u përhap konflikti kolonial anglo- francez, u njoh si Lufta e Mbretit William.²⁰

Lufta e tretë e tij, lufta e Lidhjes Augsburg, shpërtheu në vitin 1688 fillimisht në ngacmimet e vazhdueshme franceze të territorit në Gjermaninë Perëndimore. Pohimet e Luigjit për kërkesa dinastie të pjesës më të madhe të tokave të perandorit hyjnor gjerman, ishte përpjekja e tij e fundit. Aleanca kundër tij u bashkuan nën armikun e vjetër William Orange, i cili pas vitit 1688 ndau fronin e Anglisë me gruan e tij Maria. Pas kësaj, Anglia tërësisht u vu në anën kundër Luigjit. Fitorja e madhe detare e Anglisë kundër Francës në Cape La Hogue më 1692, tregoi se jo Franca, por Anglia do të jetë mbizotëruese e detit.²¹

Më 1679 Paqja e Rysvikut i dha fund luftës së përgjithshme, duke e lënë Holandën të papushtuar, por me kufi francezë të zgjeruar gjër në Rin. Austria ishte nën sundimin e Leopold I, perandor i Gjermanisë nga viti 1657-1705, krenaria dhe jo kompetenca e të cilit plotësisht e pengoi atë të jetë çfarë parashihte pozita e tij, udhëheqës i Habsburgëve, lider i opozitës, qendër rreth të cilës gjithë Evropa do t'i bënte ballë lakmive territoriale të Luigjit XIV. Leopoldi urrente Luigjin, urrente gjithashtu

19 C. Briton, J. B. Christopher, R. Lee Wolff, *Modern Civilization, Engelwood Cliffs, New Jersey*, f. 168.

20 C. J.H Hayes, *A Political and Social History of Modern Europe, Volume I* (www.gutenberg.org).

21 C. Briton, J. B. Christopher, R. Lee Wolff, *Modern Civilization, Engelwood Cliffs, New Jersey*, f. 172.

ngritjen e “Brandenburgut” protestant, Holandën tregtare, urrente cdo kënd që kishte guxim të ndërhynte mbi rregullin antik te superioritetit te tij, kush refuzoi të njihte autoritetin e tij të fuqishëm. Për më tepër, Austria ishte përsëri e zënë me luftërat e pashpresa me turqit. Rrethimi final ishte më 1683.

Çdo luftë ndërmjet Anglisë dhe Luigjit XIV u pasua me grindje ndërmjet kolonive të tyre rivale.²²

Luftërat osmano-austriake dhe Lidhja e Shenjtë

Në mesin e shekullit XVII gjendja ndërkombëtare e perandorisë osmane u keqësua. Si rezultat i rënies së Perandorisë Osmane, në Lindjen e Afërme u rrit edhe më shumë pozita e shteteve më të mëdha të Evropës Perëndimore. Me anë të kapitullimeve ato shtrinin kthetrat ne territorin e perandorisë. Në këtë periudhë ishte rritur ndikimi i Anglisë dhe Holandës.²³

Meqë Austria ishte në fazën e vet te mëkëmbjes, për Perandorinë Osmane ajo paraqiste rrezik gjithnjë e më të madh. Me Austrinë Perandoria Osmane zhvilloi gjithsej tri luftëra: I. 1595-1606, II. 1663-1664, III. 1683-1699. Gjatë dy luftërave të para ajo nuk e arriti atë që dëshiroi. Mirëpo, periudha njëzetvjeçare e lidhjes së Paqes së Vashvarit afrohej. Porta dëshironte me Austrinë të zgjaste paqja, mirëpo përkundër dëshirës së saj prapë se prapë triumfoi rryma luftarake. Veziri i madh (sadriazemi) Kara Mustafa pasha, i cili e konsideronte veten pushtues të kallëpit të vjetër, e futi Perandorinë në luftën e tretë osmano-austriake (1683-1699), me qëllim që fuqinë e Perandorisë ta mëkëmbe ne nivelin e dikurshëm. Qëllimi i tij kryesor ishte ta thyente Austrinë në mënyrë që perandorisë t’i siguronte hegjemoninë në Evropën Qendrore, por me te mendonte që edhe vetes t’i sillte famë dhe lavdi. Rryma luftarake osmane mendonte se situata ishte e përshtatshme, meqenëse në Austri u shfaqën çrregullime të brendshme.²⁴

Luftën më të gjatë shteti osman e zhvilloi me Austrinë. Lufta filloi më 1683. Pretekst ishte përkrahja që i beri Austria grupit antiosman.

22 Rossiter Johnson, *The Great Events by Famous Historians*, Volume XII, 1905 (www.gutenberg.org).

23 Petrika Thengjilli, *Historia e Perandorisë Osmane*, SHBLU, Tiranë 1997, f. 177.

24 S. Rizaj, *Histori e Pergjithshme...*, f. 251.

Gjersa një ushtri e madhe osmane po ngrihej në Edrene, perandori formoi një koalicion të ri evropian për t'i qëndruar kërcënimit. Aleati i tij kryesor ishte Jan Sobieski i Polonisë. Papa Inocenti XI bëri thirrje kudo për një kryqëzatë të re të krishterë, duke shkuar deri aty sa të kërkojë edhe ndihmën e shahut të Iranit, por megjithatë kundërshtimi i Francës i asgjësoi pjesërisht ndikimet e thirrjes, ai arriti megjithatë të siguronte njerëz dhe të holla për Habsburgët nga Spanja dhe Portugalia, si dhe nga Polonia dhe princërit e ndryshëm në Gjermani. Kryeqyteti austriak u rrethua nga osmanët në korrik të vitit 1683. Mirëpo fortifikimet e rënda dhe një mbrojtje e vendosur e qytetit, e mbështetur fuqishëm nga arritja e Sobieskit në çastet e fundit, i detyruan osmanët të tërhiqen në shtator 1683.²⁵

Kjo disfatë e ushtrisë osmane ngjalli shpresa për dëbimin e osmanëve nga Evropa, por realizimi i saj kërkonte bashkimin e forcave të disa shteteve. Me iniciativën e Papës prej vendeve të krishtera, më 1684 u formua "Aleanca e Shenjtë", në të cilën hynë Austria, Venediku, Polonia, Rusia dhe disa shtete të vogla të krishtera. Forcat e Lidhjes së Shenjtë filluan luftën më 1686. Ushtritë austriake morën Budën që kishte 160 vjet që ndodhej në duart e osmanëve, thyen në Mohaq ushtrinë osmane, në vendin ku më 1526 u vendos fati i Hungarisë dhe Beogradin, në Vidin pranë Danubit, u thyje flota osmane. Në suksesin e forcave të Lidhjes së Shenjtë ndikoi edhe lufta çlirimtare e popujve të Ballkanit për të flakur zgjedhën osmane. U ngritën serbë, bullgarë, grekë dhe shqiptarë. Ne këto rrethana të përshtatshme ushtria austriake përparoi në Bullgari dhe tokat shqiptare.²⁶

Sukseset e ushtrive austriake e shqetësuan Francën, prandaj ajo u hodh në luftë kundër Austrisë. Austria, duke mos qenë në gjendje të luftonte në dy fronte, u tërhoq nga lufta me shtetin osman. Kështu brenda një kohe të shkurtër forcat osmane u shkaktuan humbje forcave austriake dhe i dëbuan nga Bullgaria, Serbia, Kosova e Transilvania. Ndërkohë, edhe anëtarja e katërt e Lidhjes, Rusia zhvilloi luftë me Perandorinë Osmane.

25 Stanford J. Shaw, *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne*, Vëllimi I, Jehona Study Center, Tiranë 2006, f. 260.

26 Petrika Thengjilli, *Histori e Perandorisë...*, f. 178.

Ndërkohë ishte lidhur marrëveshja paqësore ndërmjet Francës dhe Austrisë. Me ndërmjetësimin e Anglisë dhe Holandës, më 1699 u lidh marrëveshja paqësore ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Austrisë, e një vit më vonë (1700) edhe midis Perandorisë Osmane dhe Ruisë. Paqja u lidh me 26 janar 1699, në Karllocin e Sremit, ndonëse marrëveshjet paqësore kishin filluar qysh në nëntor 1689. Sipas paragrafit të kësaj paqeje, Perandoria Osmane mbeti pa shumë territore të saja. Austria (Gjermania) mori afro 250.000 km², Hungarinë, Erdelinë, Sllovakinë, Kroacinë, Sllavoninë, Transilvaninë, Temishvarin pa Banatin, i cili mbeti në duart të osmanëve.²⁷

Anëtarët e tjerë të Lidhjes së Shenjtë nuk u harruan: Polonia rimerrte Podolone deri në Dnjeper; në Mesdhe Venediku ruante Morenë dhe Korintin, Korfuzin, Zanten, Qefalonine, zgjeronte territorin e vet në Dalmaci rreth Zarës dhe konfirmonte privilegjet e tij tregtare në brendësinë e perandorisë së sulltanit. Me Pjetrin e Madh bisedimet përfunduan në Stamboll në korrik 1700: Rusia mbante Azovin dhe territoret e pushtuara gjatë Dnjestrin, ndërsa Porta premtonte që t'u ndalonte tartareve inkursionet e reja.²⁸

27 S. Rizaj, *Histori e Pergjithshme...*, f. 261.

28 Georges Castalan, *Histori e Ballkanit*, Çabej, Tiranë, f. 209.

Mr. Armend MEHMETI

SUMMARY

INTERNATIONAL RELATIONS IN EUROPE IN THE 17-CENTURY

The 17-century begins by exploring European religious divisions that led to assassinations and to widespread warfare, especially in the Thirty Years War 1618-1648. More than a religious conflict between Protestants and Catholics, it was also struggle for power within and between the European Kingdoms.

This war devastated much of Germany, and for a while made Sweden a great power. It also profoundly affected France, Spain and Netherland. In France, Cardinal Richelieu and Jules Mazarin strengthened and centralized state power, though at times their policies came perilously close to disaster. Anyway France became the most powerful state in Europe replacing the Habsburgs both in Spain and the Holy Roman Empire. In Spain, disaster struck, and the Spaniards lost their long war with the Dutch, who formed a prosperous independent republic. Spain also lost control of Portugal.

In the second half of the century Louis XIV increased royal power at home and French power abroad, but at a very high cost in lives and cash. The France of Louis threatened to dominate Europe, and to oppose him other powers laid aside their religious differences, which were becoming less important in the increasingly secularized and scientific atmosphere of the late 1600s. By the end of the century two powers in particular were rivaling France, namely Holland and England. Both benefited from the shift of Europe's economic center of gravity from the Mediterranean to the Atlantic. In both, agricultural and commercial changes were taking place which would soon pave the way for the Industrial Revolution.

The 17-century showed a declining Ottoman Empire. This empire was dealing with its internal economic, social and political unrests,

while on the international scene continually fighting with neighbors, often unsuccessfully, which resulted with reduction of its territories. At the same period strong centralized European states entered into worldwide international competition for wealth and power, accelerating the pace of colonization in America and Asia. The Dutch, French, Spanish, English, and others, were all struggling to maintain and extend colonies and trading posts in distant corners of the globe, with profound and permanent consequences for the whole world. They also fought one another in Europe, where warfare grew increasingly complex and expensive. To gain an edge against other powers in war, European governments invested in research in military technology, and the seventeenth century was consequently an age of military revolution.

The rise of nation-states in the seventeenth century Europe led to the development of the concepts of national interests and the balance of power. The former concept meant that the diplomatic objectives of nations should be based on state interests and not on personal ambition, rivalries, sentiment, religious doctrine, or prejudice. The balance of power theory was based on a general interest in maintaining the state system by seeking equilibrium of power among the most powerful nations.

